



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 13.06.2017

**Vendim**  
**Nr. 67, datë 13.06.2017**

**PËR BLERJEN E SERVERIT DHE AKSESORËVE TË TJERË NË FUNKSION  
TË WEB-it TË UV-së DHE MARRJEN NËN KONTROLL (DOMAIN DHE  
HOSTING) TË TIJ NGA DREJTORIA E IT-së DHE STATISTIKAVE**

Në mbështetje të shkronjës *d*, pika 3 në nenin 3 në Ligjin Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.06.2017

**VENDOSI:**

1. Në përfundim të kontratës së lidhur mes UV-së dhe kompanisë "Fastech", *domain*-i dhe shërbimi *hosting* i WEB-it të institucionit të kalojë nën kontroll të plotë të Drejtorisë së IT-së dhe Statistikave.
2. Për një Web bashkëkohor dhe modern, i cili i shërben qëllimeve të institucionit, brenda muajit korrik, të blihen serveri dhe aksesoret përkatës: inverter > 3.5 KW, bateri 100 Ah (Gel), UPS > 3.5 KW, software + certifikata sigurie, në funksion të pavarësisë së plotë nga kompani kontraktore e nënkontraktore.
3. Vendimi t'i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e IT dhe Statistikave.
5. Vendimi regjistrohet dhe arkivohet.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.